

VENDIM
Nr.876, datë 17.12.2004

**PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË DISA PARCELAVE PYJORE
E KULLOSORE, NGA MINISTRIA E BUJQËSISË DHE E USHQIMIT MINISTRISË SË
MBROJTJES DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “ PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743. datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të nenit 7 të ligjit nr.7623, datë 13.10.1992 “Për pyjet dhe Policinë e Shërbimit Pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Parcelave pyjore, me numrat rendorë 192, 193.a e 193.b, pjesë të ekonomisë pyjore “Mali i Molishtit”, komuna Poshnjë, dhe parcelave kullimore, me numrat rendorë 15, “Ura e Kuçit - Mali i Kulës - Mali i Shpiragut”, fshati Vokopolë, bashkia Ura Vajgurore, dhe 16, “Ura e Kuçit - Mali i Kulës - Mali i Shpiragut”, fshati Poshnjë, komuna Poshnjë, me sipërfaqe të përgjithshme 76 ha e 805 m² (shtatëdhjetë e gjashtë hektarë e tetëqind e pesë metra katrorë), sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi, t’u ndryshojë përgjegjësia e administrimit nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit te Ministria e Mbrojtjes, për t’u përdorur për ngritjen e kazermës ushtarake nr.1103, Poshnjë - Berat.

2. Parcelat pyjore dhe kullimore, të përcaktuara në pikën I, të përfshihen në pronën nr.1036, me emërtimin “Poligoni tankdrom”, komuna Poshnjë, Berat, në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i ujëmbledhësit në Kutalli, Berat, me sipërfaqe 5,47 (pesë hektarë e dyzet e shtatë metra), të vazhdojnë të bëhen nga Shoqata e Përdorimit të Ujit, Poshnjë-Kutalli, Berat.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**PARCELAT E DREJTORISË TË SHËRBIMIT PYJOR BERAT, TË CILAT KALOJNË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES**

Nr.	Nr. Invent.	Nr.faqes	Nr.parcelës	Sip.ha	Destinacioni	Vërejtje
1	2450	50	192	3.7	Pyll mbrojtës	Komuna Poshnje
2	2451	50	193.a	3	Pyll mbrojtës	Komuna Poshnje
3	2452	50	193.b	2.1	Pyll mbrojtës	Komuna Poshnje
4	2789	424	16	43.005	Kullotë	Komuna Poshnje
5	2772	416	15	25	Kullotë	Bashkia U.Vajgurore

Shuma

76 805